

Nr. Prot. 011/B/21

Nr. i Regjistrir: 50

RREGULLORE
PËR
PLANIN KOMBËTAR TË NUMERACIONIT PËR RRJETET E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

KAPITULLI I
Baza Ligjore, Qëllimi e Fushëveprimi dhe Definicionet

Neni 1
Baza Ligjore

- 1.1 Kjo rregullore është nxjerr në mbështetje të dispozitave; nenit 10, paragrafët 11) dhe 12), nenit 45, paragrafët 1), 2) dhe 3), nenet 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, dhe 54 të Kreut VII, dhe Kreut VIII të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si - Ligji*).

Neni 2
Qëllimi dhe Fushëveprimi

- 2.1 Qëllimi i kësaj Rregulloreje është definimi i Planit Kombëtar të Numeracionit, përcaktimit të strukturës, gjatësisë dhe procedurave për dhënien e numrave për qasje në rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimeve elektronike, si dhe identifikuesit tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike, ashtu që të:
- a) sigurojë strukturim dhe shfrytëzim efikas të numrave dhe serive të numrave;
 - b) plotësojë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave;
 - c) sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme,

transparente dhe jo-diskriminuese;

- d) zbatoj parimin e neutralitetit teknologjik;
- e) të mbrojnë interesat e parapaguesve të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

2.2 Plani i Numeracionit i referohet caktimit dhe përdorimit të numrave, serive numerike dhe blloqeve numerike si dhe identifikuesve tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike:

- a) Planin e Numeracionit për shërbimet e telefonisë sipas Rekomandimit të ITU-T E.164;
- b) Planin e Identifikimit për rrjetet dhe shërbimet publike mobile (kodet e rrjeteve mobile – MNC) sipas Rekomandimit të ITU-T E.212;
- c) Kodet e Pikave të Sinjalizimeve ndërkombëtare (ISPC) dhe Kodet e Pikave Kombëtare të Sinjalizimeve (NSPC) sipas Rekomandimit të ITU-T Q.708;
- d) Kodet IIN (Issuer Identifiers Number) sipas Rekomandimit të ITU-T E.118;
- e) Plani i Numeracionit për shërbimet e mesazheve të shkurta me vlerë të shtuar (*tutje referuar si – VAS SMS*).

Neni 3 **Definicionet**

3.1 Për qëllim të kësaj Rregulloreje;

3.1.1 Kuptimi apo definicioni i secilës fjalë, frazë apo shprehje, sipas Ligjit gjithashtu do të jetë i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë Rregullore.

3.1.2 Shprehjet, frazat, dhe shkurtesat e mëposhtme do të kenë kuptimin si në vijim;

- a) **Bartshmëria e numrit** - paraqet të drejtën e parapaguesve që të mbajnë numrin ekzistues, emrin dhe adresën gjatë ndërrimit të ofruesit të shërbimeve të telekomunikimit;
- b) **ITU** – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve dhe ITU-T – Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve – Sektori i Standardizimeve;
- c) **Operator** – ndërmarrës, që ofron ose është i autorizuar që të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese;
- d) **Ofrues i shërbimeve** – ndërmarrës që ofron ose është i autorizuar që të ofron shërbime publike të komunikimeve elektronike;

- e) **Plani kombëtar i numeracionit** – struktura e numrave dhe e serive të numrave, emrave ose adresave, si dhe përcaktimi i tyre për sigurimin e qasjes në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike publike;
- f) **Parapagues** – cildo person fizik ose person juridik që ka lidhur një kontratë me një ndërmarrës që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara.
- g) **Shërbimi Centrex (Central Office Exchange Service)** – Shërbim, i cili mundëson simulimin e centralit shtëpiak (*Private Branch Exchange – PBX*) brenda sistemit më të madh komutues.
- h) **Shërbimi i telefonisë pa pagesë** - shërbim pa pagesë për thirrjen e parapaguesit fundor pavarësisht nëse thirrja fillon nga rrjetet fikse apo ato mobile;
- i) **Rezervimi i numrave** - veprimi i Autoritetit që t'i lejojë aplikuesit sipas kushteve të vëna në Vendimin e Autoritetit që t'i marrë nën shërbim resurset e numeracionit për përdorim të mëvonshëm;
- j) **Caktimi i numrave** - ndryshimi i statusit të rezervimit të numrave si rezultat i përputhshmërisë me kushtet për ndarje të paraqitura në Rregulloren e Numeracionit dhe dispozitave të tjera ligjore, të cilat i lejojnë aplikuesit që t'i ushtrojë të drejtat e tyre për përdorimin e resurseve të numeracionit;
- k) **Revokimi i numrave** - tërheqja e së drejtës për përdorim të resurseve të caktuara ose rezervuara të numeracionit;
- l) **Resurs i numeracionit** - numrat, blloku i numrave, dhe identifikuesit tjerë;
- m) **Prefiksi** - Prefiksi paraqet një tregues të përbërë nga një apo më shumë shifra dhe mundëson zgjedhjen e llojeve të ndryshme të numrave (si lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar), rrjeteve tranzitore dhe/ose shërbimeve.
- n) **Kodi shtetëror** – Paraqet kombinimin e një, dy apo tri shifrave dhe karakterizon vendin që thirret sikurse është përcaktuar nga ITU-T;
- o) **Kodi kryesor** – Paraqet një shifër apo kombinim shifrash (me përjashtim të prefiksit kryesor kombëtar) që karakterizon zonën e numeracionit të thirrur në vend. Kodi kryesor zgjedhet para numrit të thirrur të parapaguesit ku parapaguesi i thirrur dhe ai që thërret janë në zona të ndryshme të numeracionit.
- p) **Numri i parapaguesit** – Paraqet numrin, i cili duhet të zgjedhet apo thirret në mënyrë që të arihet një parapagues në rrjetin e njëjtë vendor apo zonë të

numeracionit. Zakonisht, ky numër tregohet në regjistrin e telefonit sipas emrit të Parapaguesit.

- q) **Numri kombëtar** – Paraqet numrin, i cili duhet të zgjedhet pas prefiksit vendor (kryesor) në mënyrë që të arrihet një parapagues në vendin e njëjtë, por jashtë rrjetit të njëjtë vendor apo zonës së numeracionit. Numri vendor përfshin kodin kryesor dhe numrin e parapaguesit.
- r) **Numri gjeografik** – Paraqet numrin kombëtar për një zonë të veçantë gjeografike.
- s) **Numri ndërkombëtar** – Paraqet numrin, i cili është zgjedhur pas prefiksit ndërkombëtar në mënyrë që të arrihet parapaguesi në vendin (shtetin) tjetër. Numri ndërkombëtar përfshin kodin e vendit të vendit të thirrur pasuar nga numri kombëtar të parapaguesit të thirrur.
- t) **Numri Nomadik** – është numri, i cili ofrohet nga ofruesit e shërbimeve të telefonisë fikse dhe nuk është i lidhur për një lokacion ose zonë të caktuar gjeografike.
- u) **Kodi kombëtar i caktuar (NDC)** – Paraqet fushën e kodit të Planit të Numeracionit që është i kombinuar me numrin e parapaguesit, përbën numrin kombëtar të përfshirë në numrin ndërkombëtar të rrjetit digjital të shërbimeve të integruara. NDC-ja përdoret që të zgjedhet rrjeti dhe /ose kodi kryesor. NDC mund të jetë një numër dhjetë shifror apo kombinim i shifrave dhjetore (pa prefikse) që karakterizojnë zonën e numeracionit në shtet.
- v) **Zona e numeracionit** – Paraqet një zonë, në të cilën parapaguesi që thërret arrin parapaguesin e thirrur vetëm në numrin e parapaguesit. Zona e numeracionit mund të përfshijë parapagues të lidhur në më shumë komutatorë (lidhës).
- w) **Shfrytëzues** – nënkupton cilindo person fizik ose juridik, i cili i shfrytëzon resurset numerike të caktuara nga Autoriteti.

KAPITULLI II

Caktimi, rezervimi dhe Tarifimi i resurseve numerike

Neni 4

Kriteret për Caktim dhe Rezervim të Numrave

- 4.1 Numrat, seritë numerike, emrat dhe adresat nga Plani i Numeracionit mund të përdoren për rrjeta dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike vetëm nëse kjo aprovohet nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti*).

- 4.2 Ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, si dhe shfrytëzuesit tjerë, të cilët dëshirojnë të shfrytëzojnë resurse numerike, janë të obliguar që të aplikojnë tek Autoriteti, për rastet e paraqitura si në vijim:
- a) Për caktim të numrave, të cilët duhet të jetë konform planit të numeracionit;
 - b) Për ndryshim, ndërprerje të numrit/serive numerike;
 - c) Për ndërrim të pronarit/transferin e numrave;
 - d) Për vazhdimin e numrave të caktuar më parë; dhe
 - e) Për rezervim të numrave.
- 4.3 Ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, varësisht nga shërbimi të cilin e ofrojnë kanë të drejtë të aplikojnë për resurset numerike si në vijim:
- a) Numra Gjeografik dhe Nomadik për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse (seritë 2x, 3x dhe 7x);
 - b) Numra Jo-Gjeografik për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile (Seria 4x);
 - c) Kodet e Qasjes dhe Kodet e Shkurta (Seria 1x);
 - d) Numra Jo-Gjeografik për ofrimin e shërbimeve të mesazheve të shkurta (Seria 5x), shërbimeve të veçanta (Seria 8x) dhe Shërbimeve me çmim të lartë/Premium (Seria 9x); dhe
 - e) Resurset, përkatësisht kodet ISPC, NSPC, MNC dhe E.118.
- 4.4 Shfrytëzuesit, të cilët nuk janë ofrues të shërbimeve të komunikimeve elektronike, respektivisht nuk janë të listuar në Regjistrin e Autoritetit për ofrim të shërbimeve mund të paraqesin aplikacionin për numra për këto raste;
- a) Kodet e shkurta (Seria 1x) për shërbime të ndryshme të interesit publik;
 - b) shërbimet e mesazheve të shkurta (VAS-SMS), seria 5x për shërbimet pa pagesë , pagesë standarde, si dhe në raste humanitare apo të ngjashme për numra me pagesë bazike Premium dhe Pagesë të Lartë Premium;
 - c) për numrat e shërbimeve të veçanta seria 8x; dhe
 - d) për numrat e shërbimeve me vlerë të shtuar 9x, kur aplikuesi nuk realizon të hyra, respektivisht nuk e përdor numrin për përfitime të veta, por për raste humanitare apo të ngjashme.
- 4.5 Për caktimin dhe rezervimin e numrave, Autoriteti do të ketë parasysh faktorët në vijim:
- a) shfrytëzimin efikas dhe efektiv të resurseve numerike;

- b) nevojën për resurse të mjaftueshme numerike që do të jenë në dispozicion për një periudhë më të gjatë kohore;
 - c) kërkesat dhe dëshirat e aplikuesit, shfrytëzuesit dhe të palëve tjera të interesuara;
 - d) të drejtën e parapaguesve për të mbajtur numrin telefonik;
 - e) shpenzimet, të cilat duhet t'i përmbushin aplikuesit dhe operatorët/ofruesit tjerë publik të komunikimeve elektronike si dhe shfrytëzuesit gjatë mbajtjes së numrit;
 - f) përdorimin e serive numerike, të cilat më parë kanë qenë të caktuara.
 - g) përshtatjen e kërkesës me kushtet e Autoritetit sa i përket ndarjes së numrave, serive numerike, emrave dhe adresave;
 - h) rekomandimet relevante të ITU dhe Bashkimit Europian, standardet dhe obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare; dhe
 - i) shërbimet e emergjencës dhe faktorët tjerë, të cilët Autoriteti i konsideron relevant për zbatimin e qëllimit të Planit të Numeracionit.
- 4.6 Autoriteti nuk do të kufizoj numrin e vendimeve për të drejtën e shfrytëzimit të resurseve numerike, me përjashtim të rasteve kur është e nevojshme për të siguruar shfrytëzimin efikas të tyre.

Neni 5

Caktimi i resurseve numerike

- 5.1 Autoriteti do t'i caktojë resurset numerike drejtpërdrejtë personit që i kërkon ato, me përjashtim të rasteve kur për atë numër ose bllok numerik, Autoriteti ka vendosur ndryshe në përputhje me nenet 50 dhe 51 të Ligjit.
- 5.2 Vendimi për caktim të numrave do të merret nga Autoriteti brenda njëzet e një (21) ditësh nga data e kompletimit të aplikacionit.
- 5.3 Nëse Autoriteti vendos që e drejta për shfrytëzimin e numrave të jepet nëpërmjet tenderit apo ankandit, atëherë limiti maksimal prej njëzet e një ditësh (21) ditësh i përcaktuar në paragrafin 5.2) të këtij neni do të zgjatet edhe për njëzet e një (21) ditë tjera.
- 5.4 Periudha kohore e caktimit në shfrytëzim të resurseve numerike të specifikuar në nenin 4.3) për ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike është e pa-kufizuar, përveç nëse nuk është e specifikuar ndryshe me vendim të Autoritetit.
- 5.5 Periudha kohore e caktimit në shfrytëzim të numrave nga seritë 5x, 8x dhe 9x për shfrytëzuesit, të cilët nuk janë ofrues i shërbimeve të komunikimeve elektronike do të jetë nga një (1) deri katër (4) vite.

- 5.6 Vendimet e lëshuara nga Autoriteti për numrat 1x, 5x, 8x dhe 9x për shfrytëzuesit tjerë duhet të implementohen nga operatorët jo më vonë se njëzet e një (21) ditë nga data e parashtimit të kërkesës nga ofruesi i shërbimeve për implementimin e numrave të cekur.
- 5.7 Kohëzgjatja e kontratës për imlementimin e numrave të caktuar nga ARKEP duhet të jetë në përputhje me afatin e përcaktuar me vendimin e ARKEP për caktimin e atyre numrave.
- 5.8 Nëse shfrytëzuesi dëshiron të mbajë resurset numerike të caktuara nga Autoriteti edhe pas afatit të përcaktuar me aktvendim, atëherë i njëjti obligohet që të paraqesë kërkesën pranë Autoritetit për vazhdimin e afatit për shfrytëzimin e tyre.
- a) Kërkesa duhet të dorëzohet tridhjetë (30) ditë para skadimit të afatit për përdorimin e numrave. Me këtë rast, shfrytëzuesi mjafton të konfirmoj përmes kërkesës me shkrim ose postës elektronike se dëshiron të vazhdoj numrin/at.
 - b) Autoriteti do të shqyrtojë kërkesën dhe varësisht prej vlerësimit do të aprovojë kërkesën ose refuzojë kundrejt arsyetimit përkatës.
- 5.9 Nëse shfrytëzuesi nuk aplikon për vazhdimin e autorizimit për përdorimin e resurseve numerike sipas afatit të specifikuar në paragrafin 5.8) të këtij neni, atëherë Autoriteti mund të caktoj resurset në fjalë për ndonjë shfrytëzues tjetër varësisht nga kërkesa. Caktimi i këtyre resurseve mund të bëhet pas periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditësh nga përfundimi i afatit për përdorimin e tyre.

Neni 6

Rezervimi i resurseve numerike

- 6.1 Autoriteti do të sjellë vendim rreth kërkesës për rezervim të numrave, serive të numrave, emrave dhe adresave brenda afatit kohorë prej njëzet e një (21) ditësh nga data e kompletimit të aplikacionit.
- 6.2 Autoriteti mund të rezervoj resurse specifike numerike për të siguruar zhvillim adekuat të rrjeteve dhe/ose shërbimeve dhe teknologjive të komunikimeve elektronike.
- 6.3 Vendimi do të përmbajë resurset e rezervuara të numeracionit, periudhen kohore të rezervimit, dhe nëse është e zbatueshme edhe kushtet tjera shtesë.
- 6.4 Në rast se Autoriteti vëren se jo të gjitha informatat janë të përfshira në aplikacion, atëherë aplikuesi do të ftohet që të kompletojë aplikacionin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve shtesë. Nëse nuk është pranuar informatë tjetër apo është pranuar informatë jo e duhur brenda 15 ditëve të punës, aplikacioni refuzohet. Refuzimi do të bëhet me anë të një Vendim të arsyetuar nga Autoriteti.
- 6.5 Në rast se është pranuar më shumë se një aplikacion për resurset e njëjta të numeracionit, aplikacioni i parë i pranuar ka përparësi (*sipas parimit i pari që vjen – i pari shërbehet*).

- 6.6 Rezervimi i numrave mund të bëhet për një periudhë deri në dy (2) vjet. Dita e parë e përdorimit të resurseve të numrave për aplikacione tregtare llogaritet si ditë e caktimit. Si pasojë statusi i rezervimit transferohet në statusin (gjendjen) e caktimit.
- 6.7 Rezervimi mund të ndërprehet nga aplikuesi përmes një kërkesë me shkrim, të dorëzuar në zyrën e Autoritetit ose nga vet Autoriteti nëse konsiderohet e nevojshme.

Neni 7

Informatat e kërkuara për Caktimin dhe Rezervimin e resurseve numerike

- 7.1 Në mënyrë që aplikuesit t'i caktohen/rezervohen resurset numerike, duhet të dërgojë të dhënat e mëposhtme/informatat tek Autoriteti:
- a) Kërkesë duke specifikuar qartë arsyet e aplikimit;
 - b) Emrin dhe qëndrimin e përhershëm, numrin e regjistrimit të biznesit, numrin fiskal, informatat e kontaktit nga dërguesi i kërkesës;
 - c) Aplikacioni i plotësuar dhe i nënshkruar vetëm nga personi i autorizuar;
 - d) Resurset e kërkuara të numeracionit;
 - e) Informatat rreth çmimeve dhe zbatimi teknik i shërbimit nëse e aplikueshme;
 - f) Datën e planifikuar për fillimin e shfrytëzimit të resurseve të numeracionit dhe afatin kohorë;
 - g) Dëshmi mbi pagesën e bërë, me përjashtim të rasteve të specifikuar në nenin 5.4, të kësaj Rregulloreje.
- 7.2 Autoriteti ka të drejtë të kërkojë informacione shtesë varësisht nga nevoja.

Neni 8

Pagesat Vjetore për Caktim dhe Rezervim të resurseve numerike

- 8.1 Tarifimi i resurseve të kufizuara numerike do të bëhet për të drejtën e shfrytëzimit (caktim) dhe rezervim. Autoriteti do të sigurohet që tarifat e tilla janë të justifikuara në mënyrë objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale në lidhje me qëllimin e tyre të synuar dhe do të marrë parasysh përmbushjen e objektivave rregullatore.
- 8.1.1 Tarifat vjetore për të drejtën e shfrytëzimit të resurseve numerike për shërbime të ndryshme janë të specifikuara në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1: *Tarifat vjetore të resurseve numerike e shprehur në euro (për numër)*

Gjeografik/Fiks dhe Nomadik (2x, 3x dhe 7x)	Mobil (4x)	Shërbime të vçanta (8X)	Premium Rate (9x)	MNC	ISPC	VAS SMS (5x)	NSPC
0.025 €	0.04 €	15 €	60 €	900 €	200 €	15 €	50 €

8.1.2 Tarifa për rezervim të numeracionit do të jetë 70% e tarifave për caktim të specifikuara në paragrafin 8.1.1) të këtij neni.

- 8.2 Pagesa vjetore për resurset e caktuara ose rezervuara për ndërmarrjet e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike do të bëhet brenda periudhes prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal, nëse Bordi i Autoritetit nuk vendos ndryshe me vendim të vecantë. Ekzekutimi i pagesës duhet të bëhet brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të faturës së lëshuar nga Autoriteti.
- 8.3 Nëse operatorët nuk e përmbushin obligimin financiar në përputhje me paragrafin 8.2), Autoriteti do të zbatojë një masë sanksionuese prej 2% të tarifës së përlllogaritur vjetore në emër të resurseve të caktuara/rezervuara.
- 8.4 Nëse vendimi për caktimin ose rezervimin e numrave dhe identifikuesve tjerë për ndërmarrjet e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike merret në gjashtëmujorin e dytë të vitit, atëherë pagesa për vitin e parë përlllogaritet 50% e tarifave të specifikuar në paragrafët 8.1.1) dhe 8.1.2) të këtij neni.

Neni 9

Revokimi i Numrave të caktuar

- 9.1 Seritë numerike/numrat, si dhe identifikuesit tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike, të cilat nuk janë përdorur brenda periudhës kohore prej dy (2) viteve do të revokohen nga Autoriteti.
- 9.2 Seritë numerike/numrat, të cilët nuk janë shfrytëzuar në mënyrë efikase dhe efektive, do të revokohen nga Autoriteti, duke i vënë ato në dispozicion të operatorëve dhe/ose ofruesve tjerë të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.
- 9.3 Kriteret kryesore për revokimin e resurseve numerike janë;
- Dështimi i përsëritur ose serioz i palës ose palëve që u janë caktuar resurse numerike, në pajtim me një ose më shumë prej kushteve të bashkangjitura në të drejtat e përdorimit të tyre (të caktimit);
 - Përdorimi jo racional dhe jo efikas i një vargu të numrave, respektivisht bllokqeve numerike. Me këtë rast vetëm numrat që nuk janë në përdorim do të revokohen.

- c) Revokimi do të jetë i nevojshëm për të siguruar mirëmbajtjen e një konkurrence të hapur dhe të drejtë;
- d) Për arsye të harmonizimit me kriteret ndërkombëtare kërkohet një revokim i tillë;
- e) Atëherë kur revokimi konsiderohet të jetë në interes të përgjithshëm kombëtar;
- f) Kur revokimi është i nevojshme si pjesë e ndryshimeve të planit kombëtarë të numeracionit;
- g) Në rastin kur Autoriteti njoftohet se poseduesi i numrave nuk i shfrytëzon në pajtim me kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore dhe Autoriteti konkludon se kjo është në dëm të parapaguesve;
- h) Kur Autoriteti e shih të nevojshme mbrojtjen e menjëhershme të parapaguesit ose për të parandaluar apo ndaluar abuzimet serioze të resurseve numerike, në këto raste Autoriteti mund të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të pezulluar përdorimin e resurseve numerike.
- i. Pezullimi i tillë mund të zgjas deri sa Autoriteti zhvillon hetimet për këto raste, por jo më gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë, me përjashtim të rasteve specifike ky afat mund të zgjatet. Nëse hetimet e Autoritetit vërtetojnë se nuk ka pasur shkelje, atëherë bëhet rikthimi i numrave ose në të kundërtën bëhet revokimi i i numrave dhe do të shqiptohen sanksione ekonomike në përputhje me Kreun XVI të Ligjit dhe rregullave të miratuara nga Autoriteti.

9.4 Pala, për të cilën është vërtetuar se ka bërë keqpërdorim të numrave, do të shënohet në bazën e të dhënave të Autoritetit në mënyrë që nëse e njëjta aplikon në të ardhmen për numra të trajtohet me kujdes të shtuar.

Neni 10

Refuzimi i Aplikacionit

10.1 Aplikimet për resurse numerike do të refuzohen nga Autoriteti për arsyet në vijim;

- a) Në qoftë se resurset e tilla numerike nuk janë në dispozicion;
- b) Aplikacioni për caktimin ose rezervimin e numrave përmban informata false, të rreme apo të pasakta.
- c) Aplikuesi nuk ka autorizimin adekuat për një caktim/rezervim të tillë;
- d) Aplikuesi nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore dhe numrat e kërkuar nuk janë konform Planit të Numeracionit;

- e) Aplikuesi kërkon t'i caktohen numra, të cilët planifikon t'i përdorë në një periudhë kohore, e cila sipas Autoritetit konsiderohet të jetë e papranueshme në funksion të shfrytëzimit efektiv;
- f) Shërbimet e planifikuara për implementimin e kodeve ose blloqeve të kërkuara numerike për caktim ose rezervim konsiderohet si jo adekuat nga Autoriteti;
- g) Aplikuesi kërkon caktim ose rezervim të resurseve të reja numerike përderisa numrat/seritë numerike, të cilat i ka në dispozicion i ka të pashfrytëzuara në pjesën më të madhe ose tërësisht;
- h) Autoriteti konsideron se caktimi ose rezervimi nuk do të jetë në interes kombëtar;
- i) Aplikuesi nuk i ka përmbushur obligimet financiare ndaj Autoritetit për resurset numerike që ka në dispozicion.

Neni 11

Shfrytëzimi i pa-autorizuar dhe mospërmbushja e obligimeve financiare

11.1 Në rast se vërtetohet përdorimi i pa-autorizuar i resurseve numerike, atëherë Autoriteti do të ndërmerr hapat si në vijim;

11.1.1 Nëse shfrytëzuesi është ofrues i shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, Autoriteti do të aplikojë një sanksion ekonomik, i cili do të jetë 50 euro për një numër për vit dhe njëkohësisht do të lëshojë urdhër me shkrim për ndërprerjen e tyre përderisa të pajiset me autorizimin përkatës;

11.1.2 Nëse shfrytëzuesi nuk është ofrues i shërbimeve të komunikimeve elektronike, respektivisht numrin/at i ka të implementuar përmes marrvëshjeve përkatëse me operatorët;

- a) Operatorit të rrjetit, i cili ka implementuar numrin/numrat, do t'i lëshohet një urdhër me shkrim për të ndërprerë shërbimet e pa autorizuar nga Autoriteti.
- b) Nëse në afatin e përcaktuar nga Autoriteti, operatori nuk i ndërpret shërbimet, atëherë do të veprohet në përputhje me nenin 102 të Ligjit për shqiptimin e sanksioneve ekonomike.
- c) Shfrytëzuesi i numrit/numrave të pa autorizuar do të paguajë për numrin/numrat e përdoruar edhe për periudhën kohore që nuk ka qenë i autorizuar nga Autoriteti. Përveq kësaj, shfrytëzuesi do të paguaj edhe një tarifë fikse prej 50 euro në emër të shfrytëzimit të pa autorizuar.

Neni 12

Transferi i së drejtës për shfrytëzimin e resurseve numerike

- 12.1 Pas aprovimit nga Autoriteti, shfrytëzuesi i resurseve numerike mund të transferojë të drejtën e resurseve numerike (përfshirë transferimin e përkohshme) tek një person tjetër, përveç në rastet kur resurset numerike për aktivitete në mbajtjen e rendit publik, shërbimet emergjente publike, dhe funksionet e tjera jo komerciale të shtetit dhe institucionet e saja.
- 12.2 Nëse është vërtetuar që resurset numerike janë shfrytëzuar në mënyrë jo efikase dhe jo efektive dhe/ apo konkurrenca është shtrembëruar nga ndonjë transfer apo akumulim i të drejtave të shfrytëzimit të resurseve numerike, Autoriteti do të veprojë konform Ligjit.
- 12.3 Autoriteti bazohet në kriteret e sipërpërmendura kur të bëjë vlerësimin dhe vendos mbi kërkesën e transferimit brenda një periudhe jo më të gjatë se njëzet e një (21) ditë nga data e pranimit të kërkesës.

KAPITULLI III

Plani Kombëtar i Numeracionit sipas Rekomandimit E.164

Neni 13

Struktura e Planit Kombëtar të Numeracionit

- 13.1 Plani Kombëtar i Numeracionit është në pajtueshmëri me rekomandimin E.164 të ITU-sektori i standardizimit.
- 13.2 Numri ndërkombëtar përbëhet nga kodi shtetëror (*ang. Country Code -CC*), i shoqëruar me numrin kombëtar (*ang. National Significant Number – NSN*), siç është treguar në tabelën 2. Prefiksi ndërkombëtar “00” përdoret për thirrjet ndërkombëtare nga Republika e Kosovës, i shoqëruar me kodin shtetëror të shtetit në të cilin drejtohet thirrja dhe numrin kombëtar. Kur operatori mbështet përdorimin e simbolit „+“, kjo do të interpretohet si Prefiks Ndërkombëtar kur përdoret në fillim të thirrjes.

Tabela 2: *Struktura e numrit ndërkombëtar*

Numri ndërkombëtar	
Kodi shtetëror	Numri kombëtar
CC	N(S)N

- 13.3 Kodi shtetëror i caktuar për Republikën e Kosovës është 383.
- 13.4 Numri kombëtar (NSN) përfshinë kodin për thirrje kombëtare (*ang. National Destination Code – NDC*) dhe numrin e parapaguesit (*ang. Subscriber Number – SN*), siç është treguar në tabelën 5. Numri Kombëtar zakonisht është 8 shifror, duke mos përfshirë kodin’0’ për prefiksin

kombëtar me sistemin e shenjave ABCDEFGH. Përjashtimet e vetme janë kodet e shkurta që përdoren për qëllime specifike në këtë plan.

Tabela 3: *Struktura e numrit kombëtar*

Numri kombëtar	
Kodi për thirrje kombëtare	Numri i parapaguesit
NDC	SN

13.5 Struktura e skemës së planit të numeracionit është paraqitur si në vijim:

Tabela 4: *Caktimi i nivelit të lartë të kodeve për t'i shërbyer Planit*

AB	Qëllimi
00 ose “+”	Kodi për prefiksin ndërkombëtar për thirrjet ndërkombëtare
0	Kodi për prefiksin kombëtar
1X	Shërbimet e Emergjencës E-112, Numrat e Shkurtër, , Shërbimet e asistencës në rrugë, shërbimet tjera të interesit publik.
2X	Seria e Numeracionit gjeografik (Telefonia Fikse)
3X	Seria e Numeracionit gjeografik (Telefonia Fikse)
4X	Seria e Numeracionit jo gjeografik (Telefonia mobile)
5X	Kodet e shkurta për shërbimet e mesazheve me vlerë të shtuar (VAS SMS)
6X	E rezervuar për përdorim në të ardhmen (M2M)
7X	Numrat Nomadik
8X	Seria e Numeracionit për Shërbime të veçanta (shërbimet telefonike pa pagesë, shpenzimet e përbashkëta, etj)
9X	Seria e Numeracionit me çmim të lartë (Shërbimet Premium)

13.6 Thirrjet ndërkombëtare mund të bëhen duke përdorur prefiksin ndërkombëtar 00, kodin kombëtar të caktuar nga ITU dhe numrin kombëtar.

13.7 Sipas Planit të Numeracionit, seria e bllokut numerik 6x është e rezervuar për përdorim në të ardhmen.

13.8 Identifikimi i linjës së thirrur (CLID – Call Line Identification) në nivel kombëtar duhet të prezantohet vetëm sipas formatit kombëtar.

Neni 14

Kodet e Qasjes dhe Kodet e Shkurta (1x)

- 14.1 Kodet e qasjes janë të shkurta, me numër nga tre (3) deri në gjashtë (6) shifra, të cilat zakonisht fillojnë me 1, që i mundësojnë shfrytëzuesit të ketë qasje në një seri të gjerë të shërbimeve telefonike.
- 14.2 Kodet e qasjes kategorizohen sipas tipit të shërbimit për të cilin përdoren. Ekzistojnë tri tipe të kodeve hyrëse: Tipi A, B dhe C.
- 14.3 Tipi A i kodeve të qasjes përdoret nga telefonuesit për të arritur në përdorimin e shërbimeve të interesit publik.
- 14.3.1 Thirrjet në kodet 116xxx, 112, 192, 193 dhe 194 duhet të jenë pa pagesë pa marrë parasyshë se nga cili rrjet origjinohet thirrja.
- 14.3.2 Identifikimi dhe thirrja e Tipit A të kodeve të shkurta duhet të jetë i njëjtë në të gjitha rrjetat. Duhet të mundësohet që kodi i tipit A të thirret nga çfarëdo rrjeti apo telefoni në Kosovë. Këto kode mund të fillojnë në një rrjet por mund të përfundojnë në cilindo rrjet tjetër. Prandaj, secili prej operatorëve dhe/ose ofruesve të shërbimeve duhet të bënë marrëveshje të duhura të interkoneksionit në mënyrë që të drejtojnë këto thirrje, p.sh. Numri për qasje emergjente 112 përfshihet në këtë kategori.
- 14.3.3 Ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile obligohen që të bëjnë të mundur dërgimin e SMS-ve në numrin 112 në mënyrë që t'u shërbej personave që kanë probleme me të folurit dhe dëgjimin ose personave, të cilët për shkak të rrethanave të caktuara nuk mund të realizojnë thirrje.
- 14.3.4 Kodet e tipit A do të dedikohen individualisht për shërbime të tilla, prej Autoritetit, dhe nuk do t'i caktohen veçanërisht një operatori ose një ofruesi të shërbimeve. Për më tepër qasja në këto kode nuk duhet të jetë e kufizuar në kohë.
- 14.4 Ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të informojë parapaguesit për çfarëdo ndryshimesh për qasje në shërbime emergjente dhe për vendndodhjen e thirrësit për shërbimet për të cilat janë parapaguar;
- 14.5 Të gjithë ndërmarrësit që ofrojnë rrjeta dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike publike duhet të sigurojnë që në përputhje me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti që parapaguesit dhe/ose shfrytëzuesit, përfshirë këtu edhe shfrytëzuesit me nevoja të veçanta dhe shfrytëzuesit e telefonave për qasje publike janë në gjendje të thërrasin shërbimet emergjente falas dhe pa pasur nevojë për të shfrytëzuar çfarëdo mjeti pagese.
- 14.6 Tipi B i kodit të qasjes (thirrjes) përdoren nga thirrësit që të kenë qasje në shërbime të gatshme prej sistemit të operatorit që ata shfrytëzojnë ose një sistemi tjetër të operatorit

publik.

- 14.7 Tipi C i kodit të qasjes është i ndarë për përdorim të pavarur prej operatorëve publik të komunikimeve elektronike, ose për të siguruar shërbime të caktuara ekskluzivisht për shfrytëzuesit që janë të kyçur direkt, ose për operacionet e brendshme të rrjetit. Kjo mund të përfshijë kodin për qasje në shërbime të shitjes, të raportimit të ndonjë prishjeje apo për pyetje të përgjithshme. Operatorët e sistemeve të ndryshme kanë mundësinë që të zgjedhin kodet përkatëse, ku është shumë e përshtatshme dhe e dobishme të merret një qasje e përbashkët, por nuk janë të obliguar ta bëjnë këtë. Një grup i kodeve të shkurtra duhet t'i caktohet çdo operatori ose ofruesi të shërbimeve në mënyrë që të ofrojnë shërbime specifike për rrjetin e shfrytëzuesve të tyre, ku thirrja drejtohet dhe do të përfundojë në të njëjtin rrjet. Prandaj, nuk është e nevojshme që thirrja e këtyre kodeve të shkojë jashtë rrjetit të operatorit.
- 14.8 Numrat emergjentë hyjnë në kategorinë e Tipit A të kodeve të qasjes. Në përputhje me Direktivat dhe Rekomandimet e Bashkimit Evropian (BE), numri 112 duhet të përdoret ekskluzivisht për qasje në shërbimet emergjente, përderisa numrat tjerë në serinë 110-111 janë të rezervuar.
- 14.9 Kodet 116xxx përdoren për shërbimet sociale të interesit publik të ofruara nga Institucionet publike.
- 14.9.1 Kodi 116 000 përdoret për fëmijët e humbur (hotline). Operatorët duhet të sigurojnë që edhe parapaguesit me nevoja të veqanta të kenë qasje në këtë numër në shkallë më të gjërë të mundshme.
- 14.9.2 Kodi 116 006 përdoret për ofrimin e ndihmës për viktimat e krimit, që kanë nevojë për mbështetje dhe informim lidhur me të drejtat e tyre. Kodi 116 111 përdoret për ndihma për fëmijë, të cilët kanë nevojë për mbështetje dhe mbrojtje.
- 14.9.3 Kodi 116 123 përdoret për ndihma psikologjike. Shërbimi i mundëson telefonuesit që të përfitojë nga një marrëdhënie e mirëfilltë njerëzore bazuar në dëgjimin jo gjykues. Ajo ofron mbështetje emocionale për thirrësit që vuajnë nga vetmia, në një gjendje krize psikologjike ose duke menduar vetëvrasje.
- 14.9.4 Kodi 116 117 përdoret për ndihma mjekësore jo urgjente. Shërbimi i drejton telefonuesit në ndihmën mjekësore të përshtatshme për nevojat e tyre, të cilat janë urgjente, por jo të rrezikshme për jetën.
- 14.9.5 Numri 116 000 duhet të jetë i disponueshëm 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë dhe të ofrohet qasje në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ndërsa numrat tjerë në këtë kategori në periudha të caktuara mund të mos jenë të qasshëm. Kur shërbimi nuk është në dispozicion të vazhdueshëm (24 orë në ditë, shtatë ditë në javë), ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë që informacionet në lidhje me disponueshmërinë të bëhen publikisht në një formë lehtësisht të arritshme, dhe që,

gjatë periudhave të padisponueshmërisë, telefonuesit në shërbim këshillohen se kur shërbimi do të bëhet i disponueshëm përsëri.

14.9.6 Kodi 116112 nuk mund të caktohet ose përdoret për asnjë shërbim.

14.10 Struktura e kodeve në serinë 1x është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 5: Caktimi i kodeve në serinë 1X

Kodi	Shërbimi	Tipi
110 – 111	E rezervuar	A
112	Shërbimet emergjente	A
116xxx	Shërbimet sociale të interesit publik të ofruara nga Insitucionet publike (p.sh. 116 000 për fëmijët e humbur (hotline), 116 006 ndihma për viktimat e krimit, 116 111 ndihma për fëmijë, 116 123 ndihma psikologjike, 116 117 ndihma mjekësore jo urgjente, etj.	A
192	Policia	A
193	Zjarrfikësit	A
194	Ambulanca	A
19xx	Shërbimet sociale të interesit publik të ofruara nga kompanitë ose personat privat (p.sh. Shërbimi i asistencës Rrugore)	A
16x-16xxx	Përdorim i pavarur nga operatorët	C
10xx	Shërbimet e gatshme të sistemit të operatorit	B

Neni 15

Seritë e Numeracionit Gjeografik (2x dhe 3x)

15.1 Seritë 2X dhe 3X janë caktuar si Seri të Numeracionit Gjeografik (*Geographic Numbering Range - GNR*) për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse. Formatit momental i numeracionit gjeografik është NDC=2 dhe 3 shifra, ndërsa SN=6 shifra, me përjashtim në disa regjione ku SN=5 shifra.

15.2 Sa i përket vendimit se si do të përdoren kodet nga seritë 2x apo 3x, Autoriteti do të ketë parasysh këta faktorë:

- zonat ku sasia e pakët e numrave mund të ketë ndikim;
- rritja e parashikuar e kërkesave për numra;
- trendet demografike dhe biznesore;

- d) prania e grupeve të interesuara;
- e) nevoja për përdorim efektiv të resurseve numerike; dhe/apo
- f) çfarëdo përfaqësimi që vjen në emër të bashkësive lokale.

- 15.3 Një tregues i zonave të shërbyera nga secili prej kodeve në GNR është specifikuar në Shtojcën II të kësaj rregulloreje. Autoriteti mund të siguroj detaje më të sakta të kufijve kur është e nevojshme.
- 15.4 Autoriteti mund të bëjë ndryshime nëpër vijat kufitare pas konsultimeve me palët relevante të interesuara.
- 15.5 Numrat gjeografikë do t'i ndahen aplikuesve në blloqe duke filluar nga një mijë (1,000) në serinë e përshtatshme të kodit të zonës, me përjashtim të rasteve të veçanta kur Autoriteti mund të vendos ndryshe me qëllim të menaxhimit efikas të resurseve numerike.
- 15.6 Operatorët e autorizuar që ofrojnë shërbime në më shumë se një zonë lokale gjeografike mund të kërkojnë caktimin e bllokut numerik për secilin prej kodit relevant në ato zona në të cilat dëshirojnë të ofrojnë shërbime me GNR.

Neni 16

Seritë e Numeracionit Jo-Gjeografik mobil (4x)

- 16.1 Seritë 4x janë të parapara për shërbimet jo-gjeografike, respektivisht ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile. Këto shërbime u mundësojnë parapaguesve që të kyçen, pa marrë parasysh lokacionin se ku gjinden.
- 16.2 Format i Numeracionit Jo-Gjeografik mobil është NDC=2 shifra dhe SN=6 shifra.
- 16.3 Blloqet e caktimit apo rezervimit për këtë seri numerike mund të jenë: dhjetëmijë (10,000), pesëdhjetëmijë (50,000), njëqind mijë (100,000), ose një milion (1,000,000), varësisht prej shërbimit.
- 16.4 Marrë në përgjithësi, operatorët e rrjetit mobil (*Mobile Network Operators- MNO*), do të kenë të caktuara blloqet prej një milion (1,000,000), përderisa ofruesit e shërbimeve mobile (*MVNO*), do të kenë të caktuar një numër të vogël të blloqeve numerike, sipas formateve të specifikuara në paragrafin 16.3 të këtij neni e që nuk mund të jetë më i madh se 300,000, përveç nëse aplikon MNO për MVNO.
- 16.5 Pagesa vhetore për numeracionin e caktuar për operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në emër të shfrytëzimit kryhet nga shfrytëzuesi, përveç nëse nuk është specifikuar ndryshe me pajtimin e palëve.

Neni 17

Kodet e shkurta për shërbime me vlerë të shtuar (5x)

- 17.1 Shërbimet e Mesazheve të Shkurta (SMS) me Vlerë të shtuar (VAS) janë tekst mesazhe që përmbajnë shërbime ose produkte për parapaguesit dhe për nga përmbajtja e tyre zakonisht kanë çmime më të lartë se tekst mesazhet standarde dhe parapaguesi duhet të jetë në dijeni paraprakisht me pagesën për vlerën e shtuar.
- 17.2 Disa nga llojet e shërbimeve VAS SMS, duke përfshirë këtu edhe përmbajtjet me pagesë premium, janë:
- a) shërbime që ofrojnë përmbajtje (p.sh. lajmërimi gol pas goli për një ekip të preferuar në futboll, etj.);
 - b) informata mbi udhëtimin – p.sh. lajme sa i përket gjendjes së trafikut (në kohë reale)/Fluturimet, të dhënat meteorologjike/motin;
 - c) votimi (shikuesit mund të jenë pjesëmarrës në programet e tyre të preferuara në kohë reale televizive, radio, lajme nëpërmjet votimit me tekst);
 - d) shërbime humanitare/donacion (kontribut për një çështje të caktuar);
 - e) aplikacione biznesi dhe tregtie;
 - f) shkarkime të zileve (ang. ring tones) për telefon;
 - g) sondazhe të ndryshme (ang. Pollings);
 - h) lojëra të fatit dhe/apo kuize me fond shpërblyes pas sigurimit të lejës (pëlqimit) nga ATK si organi kompetent për zbatimin e Ligjit për Lojrat e Fatit;
 - i) konkurse;
 - j) informim i vendndodhjes, etj
- 17.3 Struktura e numeracionit për shërbimet SMS me vlerë të shtuar (përfshirë shërbimet EMS¹/MMS²) është e përbërë nga një kod 5 shifror 5ABCD, shifra e parë e së cilit është 5 ndërsa shifra e dytë tregon çmimin, përkatësisht llojin e shërbimit (Tabela 6).
- 17.4 Kodet e shkurtër, të cilat do të caktohen sipas këtij Plani të Numeracionit janë aktualisht të realizueshme vetëm në/nga rrjetet mobile. Kodet e ngjashme nuk do të jenë në dispozicion në rrjetet fikse.
- 17.5 Kodet në dispozicion janë të ndara në blloqe të ndryshme për qëllime të tarifimit ndaj parapaguesit, ndërsa caktimi i tyre për nga sasia do të bëhet varësisht nga arsyeshmëria e kërkesës së aplikuesit. Kodet e specifikuar në tabelën në vijim kanë këtë kuptim:

¹ Enhanced Messaging Service

² Multimedia Message Service

- a) **Tekst pa pagesë** nënkupton që të gjithë SMS e dërguar në numrat që i përkasin këtij blloku të numrave do të jenë pa pagesë për parapaguesit.
- b) **Pagesë standarde** nënkupton pagesë e ngjashme me SMS-et e zakonshëm që ju tarifohen parapaguesve.
- c) SMS me pagesë **Bazike Premium** nuk duhet të shfrytëzohen për shërbime ku tarifa e tejkalon vlerën e përcaktuar në tabelë.
- d) Kodet **me pagesë të lartë Premium** mund të shfrytëzohen për shërbime ku pagesa është e lartë (p.sh. 0,50€), që do të thotë se ky bllok i numrave nuk mund të përdoret për shërbime të cilat implikojnë pagesë më të ultë.

Tabela 6: Kodet që do të jenë ne dispozicion për shërbimet me vlerë të shtuar me SMS

Bloku	Lloji i Shërbimit	Kodet në Dispozicion	Vërejtje
50 000 - 50 999	Tekst pa pagesë	1,000	
51 000 - 51 999	Pagesë standarde	1,000	
52 000 - 52 999	E rezervuar	1,000	
53 000 - 53 999	Pagesë Bazike Premium	1,000	Tarifa max. deri në 0,50€ (përfshirë TVSH)
54 000 - 54 999	E rezervuar	1,000	
55 000 - 55 999	Pagesë e lartë e Premium	1,000	Tarifa më e madhe se 0,50€ (përfshirë TVSH)
56 000 - 58 999	E rezervuar	3,000	
59 000 - 59 999	Për te rritur /çmimi i ndryshueshëm	1,000	

- 17.6 Operatorët e rrjetit nuk do t'i tarifojnë thirrjet e origjinuara për dërgimin e tekst mesazheve në numrat mobil 50xxx, pavarësisht se cilët operatorë ose ofrues të shërbimeve janë të përfshirë në thirrje;
- 17.7 Tarifimi i parapaguesve për tekst mesazhet e dërguara në numrat mobil 51xxx në asnjë rast nuk duhet të kalojnë koston, e cila është caktuar për tekst mesazhet standarde SMS nga rrjeti prej të cilit mesazhi është origjinar;
- 17.8 Kodet e shkurtër për SMS me pagesë Premium janë numrat që i përkasin vargut 54xxx deri 59XXX;
- 17.9 Tarifa për parapaguesit që dërgojnë SMS në bllokun e numrave mobil 53000-53899 (shërbimet me pagesë bazike Premium) në asnjë rast nuk mund të kalojnë vlerën 0,50€.

- 17.10 Lloji i mesazheve për të rritur (p.sh. ato që lidhen me dhunën ose bixhoz ose të atyre me përmbajtje erotike, të njohura si shërbime të mbyllura), do të sigurohen vetëm duke përdorur numrat Premium rate 59xxx.
- 17.11 Tarifa për parapaguesit që dërgojnë SMS të ndonjë shërbimi me pagesë Premium duhet deklaruar qartë nga ofruesit e shërbimeve me pagesë Premium në të gjitha promovimet e tyre.

Neni 18

Numrat jo-gjeografik Nomadik (7x)

- 18.1 Ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të lejojnë përdorimin e shërbimit publik telefonik nomadik nga parapaguesit e tyre në përputhje me Ligjin.
- 18.2 Struktura e numrave nomadik do të jetë 7A BCD EFG.
- 18.3 Sa i përket thirrjeve në numrat emergjent, të cilët origjinojnë nga numrat nomadik përmes shërbimeve VoIP, operatori është i obliguar që së bashku me thirrjen të dërgoj një indikator të veçantë në mënyrë që të informohen shërbimet e emergjencës se kjo thirrje nuk mund të lokalizohet me saktësi.
- 18.4 Operatori, i cili ofron shërbimet VoIP nomadike është i obliguar që t'i informoj parapaguesit e tij së paku dy (2) herë në vit dhe gjatë parapagimit të shërbimit rreth limitimeve që kanë për përcaktimin e lokacionit me rastin e thirrjeve emergjente. Metoda e njoftimit mund të definohet nga operatori si shënim në faturë ose forma tjera.

Neni 19

Numrat jo-gjeografik për Shërbime të veçanta (8x)

- 19.1 Seria 8x e numrave është përcaktuar ekskluzivisht për Shërbimet të veçanta.
- 19.2 Struktura e serisë së numeracionit për shërbime të veçanta do të jetë: 80A BCDEF.
- 19.3 Çmimi i thirrjes për serinë 8x do të jetë;
- a) e paguar prej palës që i telefonojmë;
 - b) e ndarë ndërmjet palës që i telefonojmë dhe telefonuesit; ose
 - c) e paguar krejtësisht prej telefonuesit.
- 19.4 Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike do të ofrojnë shërbime me tarifa të përmendura, të cilat nuk do të jenë më të mëdha se tarifat për thirrje

standarde gjeografike në seritë 2x dhe 3x.

Tabela 7: *Caktimi i numrave të posaçëm të kodit numerik në serinë 8X*

Kodi	Shërbime
800	Telefonuesi nuk ngarkohet me pagesë
801	Kostoja ndahet me operatorin
802	Kostoja e Paguar prej telefonuesit

- 19.5 Seria, 800 do të përdoret për shërbime ku thirrësi nuk paguan (Shërbimet telefonike pa pagesë – Free Phone) pa marrë parasyshë se nga cili rrjet realizohet thirrja (përfshirë rrjetet mobile).
- 19.6 Kohë pas kohe, Autoriteti mund të përcaktojë nën-seri të mëtejme për shërbimet e veçanta duke përfshirë edhe tarifat.
- 19.7 Autoriteti do t'i publikojë ndryshimet e tilla përmes ueb-faqes dhe mënyrave tjera të duhura.

Neni 20

Numrat jo-gjeografik për Shërbimet me çmim të lartë (9x)

- 20.1 Seria 9x është e dedikuar për Shërbimet me çmim të lartë (Premium).
- 20.2 Numrat Premium duhet të arrihen nga cilado rrjet (përfshirë edhe rrjetet mobile).
- 20.3 Struktura e serisë së numeracionit për shërbime premium do të jetë: 9A0 BCDEF dhe klasifikohen si në tabelën në vijim.

Tabela 8: *Klasifikimi i Shërbimit Numerik me çmim të lartë*

Kodi	Shërbimet
900	Shërbimet me çmim të lartë
960	Shërbime me çmim të lartë, për të rritur

- 20.4 Shërbimet me çmim të lartë zakonisht përmbajnë karakteristikat si në vijim:
- ato paguhen nëpërmes llogarisë telefonike të parapaguesit;
 - ato ngarkohen me çmim më të lartë se Shërbimet e veçanta në serinë 8X;
 - të ardhurat për këto thirrje, të cilat përmbajnë çmimin e thirrjes telefonike plus përmbajtja, produkti apo shërbimi, ndahet ndërmjet operatorit dhe ofruesit të shërbimeve qoftë direkt ose indirekt; dhe
 - përfshijnë ngarkimin me çmim për thirrje ose për produktet dhe shërbimet e ofruara gjatë ose direkt si pasojë e thirrjes, ku ngarkesa e pagesës është pjesë e shtuar ose e formon një pjesë të ngarkesës së përgjithshme, për atë shërbim i cili e dërgon atë

përmbajtje, produkt ose shërbim.

- 20.5 Të gjithë ofruesit e shërbimeve Premium obligohen që pa pagesë të njoftojnë tarifën maksimale, e cila i ngarkohet thirrësit para se të realizohet thirrja.
- 20.6 Nëse rritet shfrytëzueshmëria e numracionit 900 dhe 960, atëherë numeracioni do të zgjerohet në 901 dhe 961 për shërbime të njëjta. Të gjitha rregullat, të cilat aplikohen për numrat 900 dhe 960 do të aplikohen edhe për numrat 901 dhe 961.
- 20.7 Ndërmarrësit e rrjeteve publike telefonike ose të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar që, kur është e mundur teknikisht dhe ekonomikisht, t'u sigurojnë parapaguesve jashtë territorit të Republikës së Kosovës, mundësinë të bëjnë thirrje drejt numrave jogjeografikë të caktuar në Republikën e Kosovës, sipas Planit Kombëtar të Numeracionit.
- 20.8 Ndërmarrësit e rrjeteve publike telefonike, ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun nuk janë të detyruar të plotësojnë detyrimin e paragrafit 20.7 të këtij neni, në rastet kur pala e thirrur ka vendosur, për arsye biznesi, të kufizojë thirrjet e gjeneruara nga zona të veçanta.

KAPITULLI IV

Planet tjera Numerike

Neni 21

Kodet e Rrjeteve Mobile

- 21.1 Bazuar në rekomandimin e ITU E.212 struktura dhe formati i Identitetit ndërkombëtar të parapaguesit mobil (IMSI) përbëhet nga 3 pjesë kryesore, të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 9: *Struktura dhe Formatit i IMSI*

IMSI		
MCC	MNC	MSIN
3 Shifra	2 deri 3 shifra	Maksimum 10 Shifra

- 21.2 Sipas rekomandimit E.212 kodet shtetërore mobile (*ang. Mobile Country Code - MCC*) administrohen nga ITU, kodet e rrjeteve mobile (*ang. Mobile Network Code - MNC*) nga Administratat e shteteve respektive (Autoriteti), ndërsa pjesa e mbetur, pra MSIN (*ang. Mobile Subscription Identification Number*) menaxhohet nga operatorët, të cilëve u janë caktuar MNC nga Rregullatori (Autoriteti).

- 21.3 Autoriteti si administrues i resurseve numerike, ka përgjegjësinë për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për caktimin dhe revokimin e kodeve MNC në nivel nacional.
- 21.4 Blloqet, të cilat do të jenë në dispozicion për t'u caktuar operatorëve për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile do të fillojnë nga MCC MNC: 221 01 deri 221 09. Në rast se paraqitet nevoja për kode shtesë, Autoriteti mund të caktoj kodet nga 221 10 e tutje.
- 21.5 Kodet do të caktohen nga Autoriteti në përputhje me afatet kohore të specifikuara nenin 5 të kësaj rregulloreje pas kompletimit të Aplikacionit të paraqitur në Shtojcën III të kësaj Rregulloreje. Në caktimin e këtyre kodeve, Autoriteti do të marrë parasysh gjendjen ekzistuese në tregun e komunikimeve elektronike.
- 21.6 Aplikuesi duhet të demonstroj nevojë për resurse dhe para së gjithash të argumentoj se alternativat tjera teknike dhe operacionale nuk janë të përshtatshme. Lidhur me këtë duhet të bashkëngjitet dokumentacioni, i cili e argumenton këtë qëndrim të aplikuesit.
- 21.7 Autoriteti rezervon të drejtën të caktoj një kod tjetër nga ai i kërkuar nga aplikuesi ose të refuzoj në tërsi aplikacionin.
- 21.8 Autoriteti do të njoftoj ITU-në për caktimin apo revokimin e kodeve brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e caktimit/revokimit.

Neni 22

Kodet e pikave Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sinjalizimit

- 22.1 Bazuar në rekomandimin e ITU-së Q.708 struktura dhe formati i kodit për pikën e sinjalizimit ndërkombëtar (ISPC) është paraqitur në tabelën në vijim. ISPC përbëhet prej formatit 14 bitësh dhe përdoret për identifikimin e pikave sinjalizuese ndërkombëtare. Ky kod binar përfshinë 3 pjesë dhe prezentohet me 3 numra decimal si në vijim:
- a) Pjesa e parë (NML) përfshinë rangun 0 deri 7,
 - b) Pjesa e dytë (K-D) përfshinë rangun 000 deri 255, dhe
 - c) Pjesa e tretë (CBA) përfshinë rangun 0 deri 7.

Tabela 10: *Formati i ISPC sipas Rekomandimit Q.708 të ITU-së*

Kodi i Pikës së Sinjalizimit Ndërkombëtar (ISPC)		
Kodi i rrjetit për Sinjalizimin e Zonës (SANC)		Pika e Sinjalizimit
N M L	K J I H G F E D	C B A
3 bita	8 bita	3 bita

- 22.2 Autoriteti si administrues i kodeve ISPC, ka përgjegjësinë për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për caktimin dhe revokimin e tyre.
- 22.3 Kodet do të caktohen nga Autoriteti në përputhje me afatet kohore të specifikuara nenin 5 të kësaj rregulloreje pas kompletimit të Aplikacionit të paraqitur në Shtojcën IV të kësaj Rregulloreje. Në caktimin e këtyre kodeve, Autoriteti do të marrë parasysh gjendjen ekzistuese në tregun e komunikimeve elektronike.
- 22.4 Operatorëve mund t’u caktohen më shumë se një (1) kod ISPC varësisht nga nevoja që kanë.
- 22.5 Autoriteti do të njoftoj ITU-në për caktimin apo revokimin e kodeve brenda periudhës prej nëntëdhjet (90) ditëve nga data e caktimit/revokimit.
- 22.6 Kodet e pikave Kombëtare të Sinjalizimeve (*ang. National Signalling Point Code – NSPC*) do të caktohen nga Autoriteti në përputhje me nevojat e operatorëve. Operatorëve zakonisht u caktohen më shumë se një (1) kod NSPC.

Neni 23

Kodet Identifikuese IIN (Issuer Identifier Numbers)

- 23.1 Në përputhje me procedurat e specifikuara në Rekomandimin e ITU-së E.118 operatorët e telefonisë mobile, pas caktimit të kodeve MCC MNC nga Autoriteti do të aplikojnë për numrin IIN (Issuer Identifier Number).
- 23.2 Numri IIN përbëhet prej maksimum 19 shifrave, ku 2 shifrat e para janë 89 dhe përcaktojnë identifikuesin e industrisë së telekomunikacionit, pastaj kodi shtetëror sipas rekomandimit ITU-T E.164, i cili për Republikën e Kosovës është 383.
- 23.3 Në përputhje me afatet kohore të specifikuara nenin 5 të kësaj rregulloreje Autoriteti do të caktoj numrat IIN për operatorët pas kompletimit të aplikacionit të paraqitur në Shtojcën V të kësaj Rregulloreje
- 23.4 Për çdo caktim ose revokim të këtyre kodeve nga Autoriteti duhet të njoftohet ITU në përputhje me procedurat dhe afatet kohore të specifikuara në Rekomandimin përkatës të ITU-së.

KAPITULLI V

Publikimi i Informatave, Raportet periodike dhe bartshmëria e numrave

Neni 24

Informatat Publike

- 24.1 Autoriteti publikon në faqen e internetit, Planin Kombëtar të Numeracionit, duke përfshirë edhe resurset e caktuara dhe ato të rezervuara të numeracionit, përveç atyre që përdoren për sigurinë kombëtare.
- 24.2 Autoriteti në kuadër të raportmit vjetor paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të tij rreth administrimit dhe menaxhimit të resurseve numerike.

Neni 25

Dorëzimi i Raporteve Periodike

- 25.1 Ndërmarrësve të rrjetave dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, të cilëve u janë dhënë numrat, seritë numerike, emrat dhe adresat nga Plani i Numeracionit duhet t'i dorëzojnë Autoritetit një raport vjetor deri më 1 Prill të secilit vit, në të cilin raport përfshihet informata mbi përdorimin e tyre.
- 25.2 Autoriteti mund të kërkojë dorëzimin e raporteve brenda intervaleve më të shkurtra kohore.
- 25.3 Raporti duhet të përfshijë informatat si në vijim për secilën seri të numrave:
- a) Caktimin e serive numerike në shërbime të ndryshme;
 - b) përqindja e pjesës së numrave në përdorim aktiv;
 - c) përqindja e pjesës së numrave që janë të rezervuar, por nuk janë në përdorim aktiv;
 - d) secilën ndarje të numrave për shfrytëzuesit tjerë;
 - e) parashikimin për shfrytëzimin e serive numerike për secilin vit, dhe
 - f) çfarëdo informate tjetër që e kërkon Autoriteti në lidhje me shfrytëzimin e numrave.

Neni 26

Bartëshmeria e Numrave

- 26.1 Ofruesit e shërbimeve dhe/ose të rrjetave publike të komunikimeve elektronike duhet të sigurojnë, me shpenzime të veta dhe në pajtim me procedurat dhe kushtet e vendosura nga Autoriteti që parapaguesit mund t'i bartin numrat e vet në rast se ka ndërrim të ofruesit të shërbimeve, ndryshim të vendit të shërbimit të ofruar apo mënyrës së ofrimit të shërbimit.
- 26.2 Kërkesa që të gjithë shfrytëzuesit e numrave nga Plani Kombëtar i Numerik nacional për të mbajtur numrat e tyre në mënyrë të pavarur nga ndërmarrësi që ofron shërbime duhet të vlejë:

- a) në rast të numrave gjeografik, në lokacion të caktuar, ku parapaguesit kanë të drejtë që të mbajnë numrin e tyre nëse e ndryshojnë lokacionin brenda të njëjtës zonë gjeografike; dhe
- b) në rastin e numrave jo gjeografik, në çfarëdo lokacioni. Ky paragraf nuk vlen për bartjen e numrave ndërmjet rrjetave të shërbimeve fikse dhe rrjeteve mobile.

26.3 Procedura e i bartshmërisë së numrave realizohet në përputhje me kritereet teknike dhe operacionale të miratuara nga Autoriteti.

Neni 27

Qasja në Numra dhe Shërbime

- 27.1 Operatorët duhet t'u sigurojnë parapaguesve qasje në numra dhe shërbime pa marrë parasyshë teknologjinë dhe pajisjen e përdorur.
- 27.2 Autoriteti mund të kërkoj nga ndërmarrjet e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun, të bllokoj, rast pas rasti, qasjen në numra ose shërbime, kur kjo justifikohet me arsye të mashtrimit (fraud) ose keqpërdorimit dhe të kërkojë që në raste të tilla ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të ndërprejnë interkoneksionin përkatës ose të ardhurat e tjera të shërbimit.

KAPITULLI VI

Dispozitat Kalimtare dhe përfundimtare dhe Hyrja në fuqi

Neni 28

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

- 28.1 Të gjithë ndërmarrësit, të cilëve u është ndaluar e drejta e përfshirjes në aktivitete të komunikimeve elektronike, gjithashtu do t'u ndalohet e drejta e shfrytëzimit të resurseve numerike.
- 28.2 Të gjithë operatorët që shfrytëzojnë seritë e numeracionit gjeografik 3x, të cilët nuk janë në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje, janë të obliguar që brenda një afati kohorë të specifikuar nga Autoriteti me Vendim të veçantë, t'i përshtatin seritë e numeracionit sipas kodit të zonës në përputhje me kërkesat e Planit të Numeracionit.
- 28.3 Kodet NSPC, të cilat aktualisht janë në përdorim nga ndërmarrjet e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike do të vazhdojnë të përdoren deri në një vendim tjetër i Autoritetit. Tarifimi për kodet NSPC do të bëhet pas caktimit të tyre nga Autoriteti.
- 28.4 Operatori, i cili ofron shërbimin Centrex (8 shifror) është i obliguar që të njoftoj dhe udhëzoj

shfrytëzuesit e numrave centrex që çdo herë të publikojnë edhe numrin 6 shifror si dhe atëherë kur është e mundur të marrin masat e nevojshme teknike për identifikimin adekuat të linjave thirrëse (*Call Line Identification*) me rastin e thirrjeve të origjinuara nga telefonia fikse drejt rrjetave tjera.

- 28.5 Autoriteti do të bëjë paralajmërim së paku një (1) vit më herët, për çfarëdo ndryshime të ardhshme në strukturën e numeracionit, në mënyrë që t'iu mundësojë operatorëve dhe shfrytëzuesve të përgatiten për këtë ndryshim.
- 28.6 Format standarde të raportimit të resurseve numerike nga shfrytëzuesit e tyre do të publikohen në ueb faqen e Autoritetit www.arkep-rks.org.

Neni 29

Hyrja në fuqi

- 29.1 Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e të miratimit nga Bordi i Autoritetit dhe mbetet në fuqi derisa nuk miratohet rregullore tjetër.
- 29.2 Kjo rregullore shfuqizon Rregulloren Nr.32 për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës (*Ref. Nr.Prot.038/B/17*).
- 29.3 Shtojcat I, II, III dhe IV janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Prishtinë, 10/03/ 2021

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

1. TË DHËNAT THEMELORE

Të plotësohet nga personi fizik

Emri dhe mbiemri	
Adresa	
Nr Personal	
Nr. Telefonit	

Të plotësohet nga entiteti ligjor

Kompania (emri i plotë)	
Adresa	
Numri Unik Identifikues	
Numri i Telefonit (Fiks / Mobil)	
E-mail	
Ueb faqe	

2. LLOJI I APLIKACIONIT

- ☐ Aplikimi për numra për herë të parë (plotëso 3.a., 3.b., 3.c., dhe/ose 3.d)
- ☐ Aplikimi për vazhdimin e numrave (plotëso 3.a., 3.b., 3.c., dhe/ose 3.d)
- ☐ Aplikimi për rezervim të numrave (plotëso 3.a., 3.b., 3.c., dhe/ose 3.d.)
- ☐ Aplikimi për ndryshimin e numrit (numrave) (plotëso 3e.)
- ☐ Aplikimi për ndërrimin e pronarit me të drejtë të përdorimit të numrit (numrave) (plotëso 3.f.)
- ☐ Aplikimi për anulimin/ndërprerjen e numrit (numrave) të dhënë (plotëso 3.g.)

3. NUMRAT/SERITË NUMERIKE

3. a. Seritë numerike gjeografike , Jo-Gjeografike mobile dhe nomadike (2x, 3x,4x dhe 7x)

Ju lutem shënoni rrjetin publik të komunikimeve elektronike, për të cilin kërkon serinë numerike_____

Zona numerike	NDC (Fiks/Mobil)	Numri fillestar	Numri i fundit	Madhësia e bllokut	Data e fillimit të përdorimit

Zona numerike	NDC (Fiks/Mobil)	Numri fillestar	Numri i fundit	Madhësia e blokut	Data e fillimit të përdorimit

Afati i specifikuar nga Aplikuesi për numra apo seri numerike _____

3.b. Numrat e shkurtër brenda zonës gjeografike 1x

Numri i shkurtër	NDC	Lloji i shërbimit	Data e fillimit të përdorimit

Afati i specifikuar nga Aplikuesi për marrjen e numrave _____

3.c. Numrat e shkurtër për SMS me vlerë të shtuar 5x

Numri fillestar	Numri i fundit	Madhësia e blokut	Lloji i shërbimit	Data e fillimit të përdorimit

Afati i specifikuar nga Aplikuesi për marrjen e numrave _____

3.d. Numrat jo gjeografik (për shërbime të veçanta 8x dhe premium 9x)

Kodi i qasjes	Numri fillestar	Numri i fundit	Madhësia e blokut	Mënyra e tarifimit (p.sh. me minut apo thirrje)	Lloji i shërbimit	Shërbi me për të rritur (Po/Jo)	Data e fillimit të përdori mit

3.e. Ndryshimi i numrit/ serive numerike

Ju lutem shënoni numrat/seritë numerike që dëshironi t'i ndryshoni

Numeracioni aktual	Numeracioni i ri	Data e fillimit të përdorimit

Informata shtesë (cekni arsyen për ndryshimin e kërkuar): _____

_____.

3.f. Ndryshimi i pronarit me të drejtë përdorimi të numrave dhe serive numerike

Ju lutem shënoni të dhënat e pronarit me të drejtë të përdorimit të numrit/ serive numerike:

(Emri dhe adresa e pronarit të mëparshëm me të drejtë përdorimi të numrit/serisë numerike)
në

(Emri dhe adresa e pronarit të ri me të drejtë përdorimi të numrit/serisë numerike)

Data e kërkuar për zëvendësim e pronarit: _____.

Informata shtesë (cekni arsyen për ndryshim): _____

_____.

3.g Anulimi/Ndërprerja i numrit të dhënë/ serisë numerike

Ju lutem shënoni numrin/ serinë numerike që dëshironi ta anuloni:

Data e anulimit: _____.

Informata shtesë (cekni arsyen e anulimit): _____

_____.

4. DOKUMENTET E BASHKANGJITURA

a. _____

b. _____

C. _____

(Emri dhe mbiemri i Aplikuesit apo përfaqësuesit të autorizuar)

(Adresa)

(Nënshkrimi)

(Data)

Ndarja e zonave sipas NDC për numrat gjeografik (2x dhe 3x)

Nr.	Seria	Zona Gjeografike (Regjionet)	Kodi Gjeografik
I	2x	Mitrovica	NDC = 28
II		Gjilani	NDC = 280
III		Prizreni	NDC = 29
IV		Ferizaj	NDC = 290
V	3x	Prishtina	NDC = 38
VI		Peja	NDC = 39
VII		Gjakova	NDC = 390

Aplikacioni për caktimin e kodeve MCC MNC (ITU-T E.212)

I. Të dhënat e Aplikuesit/Applicant Details

1.1	Emri i Operatorit	
1.2	Numri Unik Identifikues	
1.3	Adresa/Street	
1.4	Kodi Postar, Qyteti/Postcode, Town	
1.5	Emri i personit kontaktues/Name of Contact Person	
1.6	Tel/Fax.	
1.7	e-mail	

II. Aplikimi/Application

2.1	Bloku për të cilin aplikohet (MCC MNC)	
2.2	Përshkrimi i aplikimit/Description of application	
2.3	Bloku kërkohet për/ The Block is required for: (përdorim komercial/Comercial operation ose Qëllim testimi/testing purposes)	
2.4	Data e fillimit të përdorimit	

I. DOKUMENTE TË BASHKANGJITURA:

- a. _____
- b. _____
- c. _____

Vendi/Place Data/Date

Nënshkrimi i Aplikuesit apo Përsnit të Autorizuar
Signature of Applicant/Authorised

Aplikacioni për caktimin e kodeve të sinjalizimit ISPC/NSPC (ITU-T Q.708)

I. Të dhënat e Aplikuesit/Applicant Details

1.1	Emri i Operatorit	
1.2	Numri Unik Identifikues	
1.3	Adresa/Street	
1.4	Kodi Postar, Qyteti/Postcode, Town	
1.5	Emri i personit kontaktues/Name of Contact Person	
1.6	Tel/Fax.	
1.7	e-mail	

II. Të dhënat për ISPC/NSPC

2.1	Qëllimi i aplikimit	
2.2	Natyra e përdorimit	
2.3	Lloji i pikës së sinjalizimit	
2.4	Emri i pikës së sinjalizimit	
2.5	Adresa fizike e pikës së sinjalizimit	
2.6	Data e vënies në shërbim	

II. DOKUMENTE TË BASHKANGJITURA:

- a. _____
- b. _____
- c. _____

Vendi/Place Data/Date

Nënshkrimi i Aplikuesit apo Përsoneit të Autorizuar
Signature of Applicant/Authorised

SHTOJCA V
Aplikacioni për caktimin e kodeve IIN (ITU-T E.118)

I. Të dhënat e Aplikuesit/Applicant Details

1.1	Emri i Operatorit	
1.2	Numri Unik Identifikues	
1.3	Adresa/Street	
1.4	Kodi Postar, Qyteti/Postcode, Town	
1.5	Emri i personit kontaktues/Name of Contact Person	
1.6	Tel/Fax.	
1.7	e-mail	

II. Aplikimi/Application

2.1	Numri Identifikues i Industrisë (MII)	89
2.2	Kodi Shtetëror sipas rekomandimit të ITU-T E.164	
2.3	Numri Identifikues IIN sipas Rekomndimit të ITU-T E.118	
2.4	Data e fillimit të përdorimit	

III. DOKUMENTE TË BASHKANGJITURA:

- a. _____
b. _____
c. _____

Vendi/Place Data/Date

Nënshkrimi i Aplikuesit apo Përsnit të Autorizuar
Signature of Applicant/Authorised